

VENDIM
Nr. 563, datë 15.7.2026

**PËR AUTORIZIMIN E MINISTRIT TË DREJTËSISË TË NEGOCIOJË
DREJTPËRDREJT ME SUBJEKTIN NDËRKOMBËTAR *G37 CHAMBERS*, PËR
OFRIMIN E SHËRBIMIT TË KONSULENCËS, PËR NDJEKJEN NË VAZHDIMËSI
TË ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE PRIORITARE NË LUFTËN KUNDËR
KRIMINALITETIT, PËR VITIN 2026**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100, të Kushtetutës, dhe të pikës 2, të nenit 52, të ligjit nr. 16/2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020, ‘Për prokurimin publik’”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e ministrit të Drejtësisë të negociojë drejtpërdrejt me subjektin ndërkombëtar *G37 Chambers*, për ofrimin e shërbimit të konsulencës, për ndjekjen në vazhdimësi të zbatimit të rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2026.

2. Negocimi të ketë në objekt këto fusha:

a) Ndjekjen në vazhdimësi të zbatimit të rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit, sipas metodologjisë së hartuar, dhe paraqitjen e tyre për miratim pranë ministrit të Drejtësisë;

b) Vlerësimin/analizimin e formateve tip, të platformave apo të mjeteve/formave të tjera të miratuara për mënyrën e raportimit dhe mbledhjen e informacionit;

c) Bashkëpunimin e bashkërendimin efektiv ndërinstitucional, përfshirë përmirësimin e mekanizmave të raportimit dhe të shkëmbimit të informacionit ndërmjet institucioneve përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit.

3. Ngarkohet Ministri i Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama